

VENDIM
Nr. 317, datë 20.8.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME
MAT SHA

(Ndryshuar me vendimin nr. 280, datë 24.6.20220

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 20.8.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Mat sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Mat (UK Mat), me shkresën nr. prot. 177, datë 3.6.2021, plotësim me shkresën nr. prot. 275, datë 21.7.2021, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence, për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit të UK Mat, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezultoi:

a) Shoqëria UK Mat ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 36 908 banorë të Bashkisë Mat;

b) Drejtuesi teknik i shoqërisë z. Nazmi Mallunxa është diplomuar në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Inxhinierisë, dega Metalurgji, në vitin 1981 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU, në vlerësimin e kërkesës për licencim, për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Mat, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi teknike-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjiellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Mat është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Mat sh.a. (me NUIS J68103917F), në kategoritë:
 - a) kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
 - b) kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura.
2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Mat sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
 - a) drejtues ligjor – Artan Thomaraj;
 - b) *drejtues teknik – Marisa Mamica.*
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Mat sh.a. është Bashkia Mat.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Mat sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Teknike-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Mat sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani